



MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DIREKTIVA E MBROJTJES 2025

DIREKTIVA E MBROJTJES 2025

Në një mjeshtëri gjecë politik në ndryshim konstant, ku lufta konvencionale është rikthyer në Evropë, ndërsa kërcënimet hibride bëhen gjithnjë e më agresive në rajonin tonë, qeveria shqiptare do të vijojë të dedikojë burime njerëzore dhe financiare në rritje përmes modernizimin e kapaciteteve mbrojtëse, duke respektuar dhe angazhimet e ndërmarrës së Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Përgjatë vitit 2025 FARSH-i dhe të gjitha agjencitë e Ministrisë së Mbrotjes do të vijojnë rritjen e kapaciteteve dhe të gatishmërisë në të gjithë spektrin e luftimit, sikundër dhe fuqizimin e mekanizmave të mbrojtjes civile.

Direktiva e Mbrotjes 2025 ka të bëjë me krijimin e një sistemi mbrojtjeje më modern, të aftë dhe më fleksibel që përputhet me detyrimet e Shqipërisë në NATO dhe BE, si dhe kontribuon në sigurinë rjonale dhe globale.

Kjo direktivë mbështet fuqizimin e instrumentit ushtarak në harmoni me instrumentet e tjera të aftësive reaguese kombëtare, në përputhje me të gjithë dokumentet planëzues, si dhe me qëllimin strategjik të riqytësimit të industrisë ushtarake në vend.

Ajo nënizon nevojën përmes modernizimit, ndërgjegjësimit dhe formimit të burimeve njerëzore të së ardhmes, bashkëpunimit të zgjeruar me aleatët ndërkombëtarë dhe përgatitje përmes një sërë sfidash tradicionale dhe të reja të sigurisë që i kanosen vendit. Përbashallimi me këto sfida kërkon reformim, përshtatje, zgjerim kapacitetesh dhe produkte cilësore të komunitetit të inteligjencës në mbështetje të vendimmarrjes politiko-ushtarake.

Objektivat e artikuluara në këtë direktivë synojnë të konkretizohen falë një politike burimesh njerëzore që vendos në qendër aftësitë dhe etikën luftarake, ekselencën akademike, disiplinën, kulturën e gjithanshme, vetëdijen historike dhe patriotizmin.

Qëllimi parësor i DM 2025 është të sigurohet që Shqipëria të mbetet e sigurt, strukturalisht dhe vijueshmërisht e qëndrueshme në kapacitetet e saj mbrojtëse dhe reaguese, dhe e integruar në kuadrin më të gjerë të mbrojtjes euroatlantike. Në këtë prizëm, prioritetet e këtij viti përbëhen nga pesë shtylla kryesore:

I. Forcat e Armatosura si kapital njerëzor kombëtar.

Ambicia jonë është që kapitali njerëzor i Forcave të Armatosura të zgjerohet në numër, aftësi dhe larmishmëri profesionesh përmes vendosur plotësisht në dispozicion të detyrave kushtetuese dhe të përparësive strategjike kombëtare. Kjo do të arrihet duke bërë bashkë, rrithë vlerave të patjetërsueshme të mbrojtjes kombëtare, kontingjente dhe personel të ri të kualifikuar, si edhe duke promovuar personelin ekzistues përmes politikave të qarta përmes stërvitjen, rritjen e mirëqenies dhe përparimit në karrierë. Disa nga synimet do të janë:

1. Rritja e numrit të ushtarakëve aktivë.
2. Rekrutimi, formimi, stërvitja dhe inkadrimi i Forcës Rezerviste.

3. Krijimi i kushteve dhe dizenjimi i programeve të veçanta për përtëritjen e lidhjes rini-FARSH, duke orientuar të rintjtë drejt nevojave të jetës profesionale civile ose drejt angazhimit profesional nën uniformë, si në komponentin aktiv, ashtu edhe në komponentin e rezervës.
4. Forcimi i kontributit brenda strukturave të NATO-s, BE-së dhe OKB-së dhe rritje e angazhimeve operacionale në misione të Aleancës dhe të Bashkimit Evropian.
5. Hapja e karrierës ushtarake për profesionistë të rinj nëpërmjet modeleve/kurrikulave inovative, në bashkëpunim me institucione shtetërore dhe private vendase dhe të huaja, si edhe në partneritet me institucionet e arsimit të lartë dhe botën akademike.
6. Ngritura e Kampusit të ri të Akademisë së Forcave të Armatosura.
7. Rishikimi i kuadrit ligjor për statusin e ushtarakut dhe autoritetet e drejtimit.
8. Mbështetja ndaj iniciativave për ruajtjen e kujtesës dhe pasurive kulturore të mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, përfshirë muzealizimin e aseteve me vlerë historike.
9. Bashkëpunimi me Kancelarinë e Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës për trajtimin dhe shprehjen sa më dinjitoze të mirënjohjes për shërbimet e dalluara dhe të qëndrueshme të FARSH-it dhe të personelit të saj, si edhe për përforcimin e dinjitetit të uniformës ushtarake dhe simboleve përbashkuese të Mbrojtjes Kombëtare.

II. Modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve.

Modernizimi i vazhdueshëm dhe rritja e kapaciteteve të Forcave të Armatosura do të vijojë përgjatë këtij viti në përputhje me Paketën e re të Objektivave të Kapaciteteve të Aleancës 2025, si dhe në funksion të rritjes së kapaciteteve të Mbrojtjes Civile, duke vlerësuar qasjen dhe bashkëpunimin gjithëpërfshirës shtetëror. Vëmendje të veçantë do të ketë si mirëmbajtja dhe përmirësimi i kapaciteteve ekzistuese, ashtu dhe shtimi i kapaciteteve të reja:

1. Mbrojtja dhe reagimi ndaj kërcënimit kibernetik dhe angazhimi sistematik në qasje inovative ndaj zhvillimeve dhe përditësimeve teknologjike ushtarake dhe civile në shërbim të Mbrojtjes.
2. Modernizimi i sistemeve të komandim-kontrollit dhe integrimi i tyre.
3. Mbrojtja kundër trajrore me bazë në tokë, dronë dhe sisteme kundër mjeteve ajrore pa pilot;
4. Investime në sisteme artillerie.
5. Rritje e gatishmërisë së flotës ajrore dhe asaj detare dhe zgjerimi i tyre me mjete të reja përmirësimeve ushtarake dhe civile.
6. Sisteme të integruara të vëzhgimit të hapësirës ajrore dhe detare.
7. Fuqizimi i Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë dhe i Forcave Speciale, përfshirë shtim të fuqisë së zjarrit dhe sisteme kundërtanke.
8. Rritja e aftësive vendase për shkollimin e pilotëve.
9. Avancimi i kapaciteteve të sigurisë dhe mbrojtjes, duke integruar zgjidhjet inovatore dhe teknologjike.

Në këtë kontekst, domosdoshmëri do të mbetet zhdërvjelltësia dhe eficiencia në menaxhimin financiar, si dhe në prokurimet e mbrojtjes, duke siguruar më shumë:

- Fleksibilitet në prokurimet e Mbrojtjes, mbështetur në transformim rregulator dhe strukturor;
- Diversifikim i procesit të modernizimit dhe blerjeve të sistemeve të armatimit;
- Përdorim i instrumenteve dypalëshe dhe shumëpalëshe të financimit për projektet e modernizimit;
- Mbështetje për rjetësimin e industrisë ushtarake dhe prodhimin e artikujve të Mbrojtjes.

III. Industria ushtarake.

Fokus të veçantë do të marrë rjetësimi i industrisë ushtarake vendase si pjesë e përparësisë kombëtare për të riindustrializuar vendin tonë, për të reduktuar varësinë nga furnizuesit e jashtëm, për të dinamizuar ekosistemin e inovacionit dhe rritjes së aftësive teknologjike, si dhe për të nxitur punësimin dhe ekonominë lokale.

Viti 2025 do të përvijojë kuadrin e zhvillimit të industrisë ushtarake në vendin tonë, duke i dhënë përparësi partneritetit publik - privat në formatin ku shteti është aksioner në veprimtarinë prodhuese.

Në këtë kontekst puna e MM-së, FARSH-it, Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, si dhe aktiviteti i agjencive të specializuara “KAYO” dhe “AIM”, do të përqendrohet veçanërisht në:

1. Modernizimin e aseteve të ish-uzinave të prodhimit ushtarak.
2. Ofrimin e një kuadri rregulator tërheqës për investitorët e huaj dhe vendas.
3. Sigurimin e një rezerve të mjaftueshme armatimesh, pajisjesh teknologjike dhe artikujsht ushtarakë.
4. Negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të investimit për linjat e reja të prodhimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar: uniformat dhe pajimet personale; municionet e kalibrave të ndryshëm; armatimin e lehtë; dronët ushtarakë dhe civilë; sistemet e vëzhgimit dhe të sigurisë perimetrale; transportuesit e blinduar; sistemet e artilerisë; mjetet lundruese etj.
5. Shfrytëzimin e infrastrukturave të tjera civile dhe ushtarake, të degraduara ndër vite, të cilat gjykojnë të dobishme në funksion të aktivitetit prodhues me përdorim të dyfishtë.
6. Lidhjen e partneriteteve me vende aleate dhe mike në funksion të transferimit dhe zhvillimit të teknologjisë.
7. Nxitja e projekteve mbi kërkimin dhe zhvillimin, nëpërmjet monitorimit e vlerësimit të zhvillimit në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale.

IV. Qëndrueshmëria kombëtare dhe Mbrojtja Civile.

Në fryshtën e nenit 3 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, busull orientimi do të jetë qasja mbarështetëreore për forcimin e qëndrueshmërisë kombëtare.

Në këtë drejtim, fokus do të marrë përmirësimi i sistemit të Mbrojtjes Civile, me qëllim mirëmenaxhimin e situatave të fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga dora e njeriut, si dhe angazhimeve shtesë në ndihmë të komunitetit.

Investimet në struktura, teknologji dhe kapacitete operacionale do të synojnë vigjilencë në rritje në të gjithë territorin e vendit për të përballuar rastet e emergjencave dhe reduktimin e rreziqeve. Vëmendja do të përqendrohet në:

1. Fuqizimin e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të situatave të Emergjencave Civile (EC), duke përfshirë shpërndarjen gjeografike të strukturave të EC-së.
2. Modernizimin e teknologjive, përforcimin kapilar të kapaciteteve operacionale (në veçanti për përballimin e situatave të zjarreve) dhe rritjen e aftësive të specializuara sipas riskut në territor (bashki/qarqe).
3. Financim të projekteve rehabilituese të infrastrukturës parandaluese (diga, prita lumore, ura etj.), sikundër dhe financim për mjete e pajisje të specializuara në mbështetje të bashkive me risk.
4. Përmirësimin e strukturës së mallrave rezervë të shtetit, si dhe shpërndarjen e saj territoriale në përshtatje me nevojat, vlerësimet e rrissqeve dhe zhvillimet demografike në vend.
5. Pastrimin e hotspot-eve dhe mbështetje me kapacitete xheniere për institucionet vendore.
6. Rishikimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të territorit dhe atij të ndërtimit, në funksion të fuqizimit të mbrojtjes civile pranë komuniteteve, duke parashikuar ndërtimin e vendstrehimeve dhe masa parandaluese në përpjesëtim të drejtë me rrisset dhe nevojat në territor.
7. Një vëmendje të posaçme do të marrë krijimi i rrjetit të vullnetarëve të Mbrojtjes Civile dhe ndërtimi i programeve ndërgjegjësuese dhe stërvitore në shkolla dhe gjimnaze.

V. Infrastruktura dhe miradministrimi i aseteve të Mbrojtjes.

Investimet në krijimin e një infrastrukturë solide për Vendin Pritës, që përfshin dhe tëresinë e projekteve rrugore, hekurudhore dhe detare në funksion të Korridorit VIII, do të kontribuojë në arritjen e objektivave të NATO-s për shkurajimin dhe mbrojtjen. Prioritet përbën siguria e linjave detare të komunikimit dhe infrastruktura nënujore kritike në hapësirën adriatiko-joniane.

Një sërë masash do të fokusohen në:

1. Investime në projekte përgjatë Korridorit VIII, përfshirë kapacitete pozicionimi, stërvitjeje dhe magazinimi.
2. Zhvillimin e infrastrukturës ushtarake në kompleksin detar Durrës-Porto Romano, në kuadër të mbështetjes së operacioneve të Aleancës.
3. Zhvillimin e mëtejshëm të Bazës Ajrore të Kuçovës dhe Poligonit Kombëtar Stërvitor Pajet/Bizë.

4. Përsosjen e kuadrit rregulator për përshtatjen e infrastrukturave civile në funksion të lëvizshmërisë ushtarake.

Paralelisht me këto investime domethënëse, asetet e Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat nuk janë pjesë e planeve operacionale apo strategjike të Forcave të Armatosura, do t'i nënshtronen një procesi miradministrimi, me qëllim:

- zhvillimin e tyre me një orientim të dyfishtë për gjenerimin e të ardhurave dhe të mirave publike në funksion të mirëmbajtjes dhe modernizimit;
- kthimin e ish-aseteve ushtarake, aktualisht nën administrimin e MM/FARSH, në zona atraktive sociale, kulturore dhe turistike.

Objektivat e artikuluara në DM 2025 nuk mund të arrihen pa një angazhim të shtuar rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë dhe pa një vëmendje të qëndrueshme qeveritare dhe ndërinstitucionale. Rritja e nivelit të sigurisë, si dhe bashkëpunimi në menaxhimin e krizave e vendos sistemin tonë të Mbrojtjes në pararojë.

Kësisoj, një element kyç për Ministrinë e Mbrojtjes do të jetë intensifikimi i bashkëpunimit me aleatët tanë, duke veçuar këto përparësi:

1. Përafrimi strategjik me politikën e jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes së përbashkët të BE-së.
2. Vijimi i partneritetit strategjik me SHBA-në në gjithë spektrin e forcave të luftimit.
3. Rritja e ndërveprimit me aleatët tanë rajonalë, veçanërisht në hapësirën adriatiko-joniane, duke kontribuar në ruajtjen e paqes, menaxhimin e krizave dhe operacionet e ndihmës ndaj fatkeqësive natyrore.
4. Bashkëpunimi i intensifikuar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes civile me Kosovën.

Pirro Vengu
Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë